



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS
BUXHETIT DHE MFK
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

INFORMACION MBI ECURINË E REALIZIMIT TË TREGUESVE KRYESORË TË TË ARDHURAVE
DHE SHPENZIMEVE, PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2024

Në zbatim të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.97/2023 datë 07.12.2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit plotësues nr. 1 datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, VKB nr. 167 datë 29.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026 të Bashkisë Korçë, VKB nr. 17 datë 15.02.2024 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2023 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2024”, VKB nr.43 datë 28.03.2024 “Për miratimin e rritjes së planit të të ardhurave dhe përdorimin e grantit për realizimin e projektit “Përfshirje sociale për ndryshim” midis Bashkisë Korçë dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), si dhe VKB nr.85 datë 14.06.2024 “Për miratimin e projektit të Rezidencës Artistike dhe miratimin e fondit të alokuar nga Këshilli i Qarkut Korçë, po ju informojmë në lidhje me ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, për periudhën janar – qershor 2024.

Buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **2,480,640** mijë lekë dhe realizimi për periudhën janar-qershor 2024 është **898,396** mijë lekë ose **36%** dhe krahasuar me planin 6 mujor në vlerën **1,501,274** mijë lekë realizimi është **60%**. Të dhënat e realizimit të buxhetit për periudhën janar-qershor 2024, duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, jepet si më poshtë:

000/lekë

Plan 2023	Plan 6M 2023	Fakt 6M 2023	% F'23/P'23	Plan 2024	Plan 6M 2024	Fakt 6M 2024	% F'24/P'24
2,271,851	1,290,931	768,216	34%	2,480,640	1,501,274	898,396	36%



Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për Bashkinë dhe Institucionet e Varësisë është 404,818 mijë lekë ose realizuar në masën 32% kundrejt planit të vitit 2024 në vlerën 1,246,212 mijë lekë dhe krahasuar me planin 6 mujor në vlerën 710,486 mijë lekë realizimi është 57%. Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore të vitit 2024, duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, jepet si më poshtë:

000/lekë


Plan 2023	Plan 6M 2023	Fakt 6M 2023	% F'23/P'23	Plan 2024	Plan 6M 2024	Fakt 6M 2024	% F'24/P'24
1,192,786	607,734	373,341	31%	1,246,212	710,486	404,818	32%

Për periudhën janar – qershor janë shlyer 70% e detyrimeve nga detyrimet e planifikuara me VKB nr.17 datë 15.02.2024 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2023 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2024”.

Detajimi i buxhetit sipas llogarive ekonomike dhe Institucioneve të Varësisë, i krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 paraqitet si më poshtë:

000/lekë


Emërtimi i llogarive	Plan 2023	Plan 6M 2023	Fakt 6M 2023	Plan 2024	Plan 6M 2024	Fakt 6M 2024	Dif Fakt 6M 2024-2023	±% e Fakt 6M 2024-2023
Shpenzime personeli 600-601	843,201	455,916	386,161	933,220	486,330	424,339	38,178	10%
Shpenzime korrente 602-609	956,251	502,402	298,505	1,094,039	633,048	363,101	64,596	22%
Shpenzime për investime 230-231	429,538	316,583	68,565	414,282	366,324	96,187	27,622	40%
Pagesa e principalit dhe interesit 166-651	42,861	16,030	14,985	39,100	15,572	14,769	(216)	-1%
Total Bashkia+Inst	2,271,851	1,290,931	768,216	2,480,640	1,501,274	898,396	130,180	17%



- Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore gjatë 2024 janë planifikuar në vlerën 933,220 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 424,339 mijë lekë ose 45%. Këto shpenzime gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 843,201 mijë lekë dhe realizuar 386,161 mijë lekë ose 46%, pra gjatë 2024 krahasuar me periudhën janar-qershor 2024 kemi një rritje prej 10%.
- Shpenzimet korrente janë planifikuar në vlerën 1,094,039 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 363,101 mijë lekë ose 33%. Këto shpenzime gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 956,251 mijë lekë dhe realizuar 298,505 mijë lekë ose 31%, pra gjatë 2024 krahasuar me periudhën janar-qershor 2023 kemi një rritje prej 22%.
- Shpenzimet për investime janë planifikuar në vlerën 414,282 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 96,187 mijë lekë ose 23%. Këto shpenzime gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 429,538 mijë lekë dhe realizuar 68,565 mijë lekë ose 16%, pra gjatë 2024 krahasuar me periudhën janar-qershor 2023 kemi një rritje prej 40%.
- Shpenzimet për principalin dhe interesin janë planifikuar në vlerën 39,100 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 14,769 mijë lekë ose 38%. Këto shpenzime gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 42,861 mijë lekë dhe realizuar 14,985 mijë lekë ose 35%.

000/lekë

Institucionet	Plan 2023	Plan 6M 2023	Fakt 6M 2023	Plan 2024	Plan 6M 2024	Fakt 6M 2024	Dif Fakt 6M 2024-2023	±% e Fakt 6M 2024-2023
Bashkia	1,072,041	610,307	302,885	1,171,458	768,334	396,207	93,322	31%
NSHMAC	489,843	271,430	188,269	541,976	324,761	219,049	30,780	16%
NSHP	564,846	327,170	214,608	599,139	316,501	212,846	(1,762)	-1%
QAK	87,313	49,048	37,662	105,796	55,397	42,096	4,434	12%
KLB shsp	51,044	29,292	23,853	55,663	32,766	26,626	2,773	12%
QDZH	550	300	-	975	495	149	149	0%
QRZH	655	355	156	925	445	286	130	83%
Shtp e Fosh	5,559	3,029	783	4,709	2,575	1,137	354	45%
Total	2,271,851	1,290,931	768,216	2,480,640	1,501,274	898,396	130,180	17%



- Shpenzimet e Bashkisë gjatë 2024 janë planifikuar në vlerën 1,171,458 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 396,207 mijë lekë, ose 34%. Këto shpenzime gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 1,072,041 mijë lekë dhe realizuar 302,885 mijë lekë ose 28%, pra gjatë 2024 krahasuar me periudhën janar-qershor 2023 kemi një rritje prej 31%.
- Shpenzimet e NSHMAC gjatë 2024 janë planifikuar në vlerën 541,976 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 219,049 mijë lekë, ose 40%. Këto shpenzime gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 489,843 mijë lekë dhe realizuar 188,269 mijë lekë ose 38%, pra gjatë 2024 krahasuar me periudhën janar-qershor 2023 kemi një rritje prej 16%.
- Shpenzimet e NSHP gjatë 2024 janë planifikuar në vlerën 599,139 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 212,846 mijë lekë, ose 36%. Këto shpenzime gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 564,846 mijë lekë dhe realizuar 214,608 mijë lekë ose 38%, pra gjatë 2024 krahasuar me periudhën janar-qershor 2023 kemi një ulje prej 1%.
- Shpenzimet e QAK gjatë 2024 janë planifikuar në vlerën 105,796 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 42,096 mijë lekë, ose 40%. Këto shpenzime gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 87,313 mijë lekë dhe realizuar 37,662 mijë lekë ose 43%, pra gjatë 2024 krahasuar me periudhën janar-qershor 2023 kemi një rritje prej 12%.
- Shpenzimet e KLB Shsp gjatë 2024 janë planifikuar në vlerën 55,663 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 26,626 mijë lekë, ose 48%. Këto shpenzime gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 51,044 mijë lekë dhe realizuar 23,853 mijë lekë ose 47%, pra gjatë 2024 krahasuar me periudhën janar-qershor 2023 kemi një rritje prej 12%.
- Shpenzimet e QRZH gjatë 2024 janë planifikuar në vlerën 925 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 286 mijë lekë, ose 31%. Këto shpenzime gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 655 mijë lekë dhe realizuar 156 mijë lekë ose 24%.

- Shpenzimet e Shtp e Foshnjës gjatë 2024 janë planifikuar në vlerën 4,709 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,137 mijë lekë, ose 24%. Këto shpenzime gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 5,559 mijë lekë dhe realizuar 783 mijë lekë ose 14%.

Bashkangjitur:

Tabela nr.1 e realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, dhe të ardhurat e Institucioneve të Varësisë për periudhën janar - qershor 2024.

Tabela nr.2 e realizimit të shpenzimeve nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale për periudhën janar-qershor 2024.

Tabela nr.3 e realizimit të shpenzimeve nga transfertat e pakushtëzuar për periudhën janar-qershor 2024.

Tabela nr.4 e realizimit të shpenzimeve nga të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe sponsorizimet për periudhën janar-qershor 2024.

Tabela nr.5 e detajimit të shpenzimeve operative (detyrime 2023) që kanë si burim financimi të ardhurat e trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale, transfertat e pakushtëzuar, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe sponsorizimet.

Tabela nr.6 e detajimit të shpenzimeve për investime (detyrime 2023) që kanë si burim financimi të ardhurat e trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale, transfertat e pakushtëzuar, të ardhurat e trashëguara nga taksat dhe tarifat vendore dhe sponsorizimet.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS

BUXHETIT DHE MFK

Valbona ZIKO

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE

E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Anxhela (DISHNICA) QERAMIXHI

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Soniel PRIFTI

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq FILO

